



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 226, Datë 09.11.2021

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ALBESP TRADING & CONSULTING” SH.P.K., PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d” nenit 5 pika 1 gërma “d” dhe nenit 10 pikat 1 dhe 3, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 09.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/5 prot., datë 02.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1021 prot., datë 26.10.2021, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:
- Formatit dhe dokumentacionit për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.

Plotësuar

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “e”. **Plotësuar**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërma “c” dhe “d”. **Plotësuar**
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike, Neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar**

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- **gërma “c”** (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentin e plotë në formën e kërkuar nga rregullorja (jo vetëm faqen e parë të dokumentit).
- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për administratorin e shoqërisë dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. si dhe për administratorin e saj.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (Vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim të Letrës Mbështetëse të lëshuar nga Credins Bank me nr. 506 prot., datë 25.10.2021, shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n nëse i ka plotësuar kriteret financiare të vendosura nga banka në kuadër të mbështetjes financiare që kjo e fundit do t’i mundësojë për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet.

Dokumentacioni Teknik për Aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike. Neni 9, pika 4.7:

- **gërma “e”**: (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi) **Plotësuar pjesërisht.** Duke qënë se shoqëria është në proces për krijimin e sistemit IT, vlerësojmë që në rast miratimi të licencimit të saj, t’i lihet si kusht depozitimi në ERE i Sistemit IT, pas krijimit.
- **gërma “g”**: (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.) **Plotësuar pjesërisht.** Në vijim të deklaratës së shoqërisë se nuk mund të krijohen zyrat përfaqësuese në këtë moment, pasi nevojitet shpërndarja gjeografike e klientëve,

vlerësojmë që në rast miratimi të licencimit të saj, t'i lihet si kusht depozitimi në ERE i dokumentacionit që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do ti ofrohen klientëve, pas krijimit të tyre.

- **gërma “”**: (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët.) **Plotësuar pjesërisht.** Në vijim do t'i kërkohet shoqërisë të bëjë me dije nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët të cilët do të furnizojë, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.